

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**ME EMRIN E ALLAHUT
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

Dr. Moris Bykaj
(Akademia e Mjekësisë e Francës)

KUR'ANI DHE SHKENCA E SOTME

E përktheu nga gjuha angleze:

Prof. dr. Hajri Shehu

Tiranë, 2014

Autori: Dr. Moris **BYKAJ**

Titulli i librit në origjinal: *The Qur'an and Modern Science*

Korrektura letrare dhe teknike: Bledar **SHEHU**

Përgatitja për shtyp: Sabrie **FEZA**

Kapaku: Sabrie **FEZA**

Botuesi: **Fondacioni i Kur'anit**

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie.....	7
Kur'ani dhe shkenca e sotme.....	9
Duhet dituri enciklopedike që të kuptohet Kur'ani.....	13
Krijimi i Gjithësisë.....	19
Astronomi– dritadhelëvizja.....	24
Toka.....	28
Krijimi injeriut.....	34
Kur'anidheBibla.....	39
Drita e Zbulesës.....	48
Kriteret e së Vërtetës.....	52
I nderuar lexues.....	54

PARATHËNIE

Dr. Moris Bykaj (Maurice Bucaille) është mjek i shquar francez, shkencëtar dhe autor i librit “La Bible, la Coran et la Science” (Bibla, Kur’ani dhe Shkenca), i cili përmban rezultatin e kërkimit të tij shkencor për Zbulesën (Revelatën) judaike - të krishtere dhe për Kur’anin. Libri është një bashkëndihmesë (kontribut) e pashoqe në fushën e fesë dhe të shkencës.

Meqë është shkencëtar i shquar, ai u përzgjodh të merrej me mumien e Faraonit (Mernepteh) – detyrë të cilën ai e përmbushi. Gjatë vizitës së tij në Arabinë Saudite, i treguan vargjet (ajetet) e Kur’anit të Shenjtë, ku Allahu thotë se trupi i vdekur i Faraonit do të ruhet si “Argument” për brezat e ardhshëm. Një shkencëtar i krishterë i paanshëm, si dr. Bykaji, që njohur me versionin biblik të tregimit për Faraonin, si i mbytur në det, duke ndjekur Profetin Musa. Ai u habit, por edhe u gëzua, kur mësoi se Kur’ani i Shenjtë bënte një parashikim të saktë – deri tani vonë,

i panjohur për botën – për ruajtjen e trupit të Faraonit të kohës së Musait. Kjo e bëri dr. Bykajin ta studionte tërësisht Kur'anin e Shenjtë, pasi mësoi gjuhën arabe. Konkluzioni i fundit i studimit të tij krahasues për Kur'anin dhe Biblën është se pohimet për dukuri shkencore në Kur'anin e Shenjtë pajtohen plotësisht me shkencat e sotme, kurse tregimet biblike për të njëjtat tema janë krejt të papranueshme nga ana shkencore.

Ky libërth, i cili është një leksion i dr. Bykajit për temën “Kur'ani dhe shkenca e sotme”, mbajtur në “Common Wealth Institute”, në Londër, do t'ju drejtojë për tek e Vërteta e përjetshme e Islamit.

KUR'ANI DHE SHKENCA E SOTME

Më 9 nëntor 1976, një leksion i pazakontë u mbajt në Akademinë e Mjekësisë të Francës. Titulli i tij qe “Të dhëna fiziologjike dhe embriologjike në Kur’an”. Unë paraqita studimin tim për disa pohime të Kur’anit që kanë të bëjnë me fiziologjinë dhe riprodhimin. Përse zgjodha këtë temë? E zgjodha sepse dija jonë për këto disiplina është e atillë, sa është e pamundur të shpjegojmë se si një tekst i kohës së Kur’anit mund të kishte ide, të cilat janë zbuluar vetëm në kohën e sotme.

Nuk ka, vërtet asnjë vepër njerëzore përpara kohëve të sotme që të përmbajë pohime, të cilat të jenë të përparuara sa dija e kohës kur ato u shfaqën dhe të cilat të mund të krahasohen me Kur’anin. Përveç kësaj, ishte i dëshirueshëm një studim krahasues i të dhënave të ngjashme,

që i përmban Bibla (Dhiata e vjetër dhe Un-gjijtë). Ja, kështu u formësua projekti i ballafaqimit midis shkencës së sotme dhe pjesëve të caktuara të Librave të Shenjtë të secilës fe monoteiste. Përfundimi qe botimi i një libri, me titullin “La Bible, la Coran et la Science” (Bibla, Kur’ani dhe Shkenca). Botimi i parë në gjuhën frënge doli në maj, 1976 (Seglers, Paris). Tashmë ka edhe një botim në gjuhën angleze dhe një në gjuhën arabe.

Nuk ka asnjë habi të mësosh se Feja dhe Shkenca janë konsideruar gjithnjë nga Islami si dy motra binjake dhe se sot, kur Shkenca ka bërë kaq hapa të mëdhenj, ato – Feja dhe Shkenca – vijojnë ende të bashkë-shoqërohen dhe për më tepër, të dhëna të caktuara shkencore përdoren për ta kuptuar më mirë tekstin e Kur’anit. Dhe, akoma më shumë, në një shekull, ku për shumë njerëz, “e vërteta shkencore i ka dhënë një grusht vdekjeprurës besimit fetar”, janë pikërisht zbulimet e shkencës që, duke vëzhguar objektivist Zbulesën (Revelatën) Islame, kanë ndriçuar karakterin e mbinatyrshëm të disa aspekteve të Saj.

Kur të thuhet dhe të bëhet gjithçka, dija shkencore – pavarësisht se ç’ mund të thonë njerëzit, - do të duket shumë ndihmëtare për të pasqyruar qenien e Zotit.

Sapo të fillojmë ta pyesim veten në mënyrë të paanshme e pa paragjykimë për mësimet metafizike që dalin nga një pjesë e dijes së sotme (për shembull, dija jonë për më të voglën pafundësisht ose për problemin e jetës), ne, vërtet zbulojmë shumë arsye për të menduar në këtë mënyrë. Kur mendojmë për organizimin e shkëlqyer të lindjes dhe të vijimit të jetës, domosdo bëhet e qartë se mundësia që ajo (lindja / jeta – H.Sh.) të jetë rezultat i rastit, bëhet gjithnjë e më pak e pranueshme, ndërkohë që zgjerohet dija jonë dhe rritet përparimi ynë në këtë fushë. Koncepte të caktuara do të duken gjithnjë e më të papranueshme – për shembull, ai që u paraqit nga fituesi francez i çmimit “Nobel” për mjekësi, i cili u përpoq t’i bënte njerëzit të pranonin se lënda e gjallë është vetëkrijuar si rrjedhojë e rrethanave rastësore nën efektin e ndikimeve të jashtme të caktuara, duke përdorur elemente të thjeshta kimike si bazë të tyre.

Nga kjo mëtohet (pretendohet) se erdhën në jetë organizma të gjallë, që çuan në kompleksin e mrekullueshëm, të quajtur njeri. Mua më duket që përparimi i arritur shkencor në kuptimin e ndërlikueshmërisë fantastike të qenieve të larta jep argumente të fuqishme në favor të teorisë së kundërt: me fjalë të tjera, ekziston një organizim tejet sistematik që mbisundon rregullimin e shkëlqyeshëm të fenomeneve të jetës.

Në shumë pjesë të tij, me gjuhë të thjeshtë, Kur'ani na çon në këtë mendim të përgjithshëm. Por, ai përmban pafundësisht edhe të dhëna më të sakta, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fakte të zbuluara nga shkenca e sotme: këto janë ato që ushtrojnë një tërheqje magnetike për shkencëtarët e sotëm.

DUHET DITURI ENCIKLOPEDIKE QË TË KUPTOHET KUR'ANI

Për shumë shekuj, njeriu nuk mundi t'i shijonte këto të dhëna shkencore (të Kur'anit –H.Sh.) sepse ai nuk kishte mjetet e mjaftueshme shkencore. Vetëm sot, shumë vargje (ajete) të Kur'anit, që kanë të bëjnë me dukuri natyrore janë bërë plotësisht të kuptueshme. Mua më duhet të shkoj më tej e të them që në shekullin XX, me përdegëzimin e dijes gjithnjë në rritje, nuk është gjithmonë e lehtë për shkencëtarin mesatar që ta kuptojë gjithçka që lexon në Kur'an për të tilla tema pa ndihmën e kërkimit të specializuar shkencor. Kjo do të thotë se, që t'i kuptosh të gjitha këto ajete të Kur'anit, të duhet të kesh patjetër dije enciklopedike, e cila sipas meje, përfshin shumë, shumë disiplina.

Unë përdor fjalën “shkencë”, me të cilën kam parasysh dijen që ka zënë rrënjë fuqishëm. Ajo nuk përfshin teoritë, të cilat për njëfarë kohe na ndihmojnë të shpjegojmë një dukuri ose një varg dukurish, që më vonë s’kanë rrugë tjetër veçse të braktisen, ngaqë dalin shpjegime që janë bërë më të besueshme në saje të përparimit të shkencës. Në parim, unë synoj të trajtoj krahasimet e bëra ndërmjet pohimeve të Kur’anit dhe dijes, e cila ka gjasë të mos jetë temë për diskutim të mëtejshëm. Sa herë që do të paraqit fakte shkencore, që nuk janë ende qind për qind të provuara, natyrisht, do ta qartësoj.

Ka, gjithashtu, shembuj shumë të rrallë thëniesh në Kur’an, të cilat deri tani nuk janë vërtetësuar nga shkenca e sotme. Unë do t’u referohem këtyre, duke theksuar se të gjitha të dhënat i bëjnë shkencëtarët t’i marrin ato si shumë të mundshme. Një shembull i tillë është thënia e Kur’anit që jeta ka një zanafillë ujore; një tjetër është se diku në Gjithësi (Univers) ka toka të ngjashme me Tokën tonë.

Sidoqoftë, këto gjykime nuk duhet të na bëjmë të harrojmë që Kur'ani mbetet libër fetar *par excellence* (në kuptimin e vërtetë të fjalës, i shkëlqyer) dhe natyrisht, nuk mund të pritet që ai të ketë qëllim “shkencor” *per se* (në vetvete). Sa herë që njeriun e ftojnë të reflektojë për veprat e Krijimit dhe për dukuritë e shumta natyrore që mund të vrojtojë, synimi i dukshëm, kur përdor shembuj të tillë është të theksojë Gjithëfuqishmërinë e Zotit,. Fakti që në këto reflektime ne mund të gjejmë aluzione për të dhëna, që lidhen me dijen shkencore, është sigurisht një nga dhuratat e tjera të Zotit, vlera e të cilave duhet të ndriçojë në një kohë, kur ateizmi materialist, i mbështetur shkencërisht, kërkon të mbizotërojë në kurriz të besimit në Zotin.

Në tërë hulumtimin tim, jam përpjekur të jem vijimisht krejt objektiv. Besoj që ia kam arritur ta trajtoj studimin e Kur'anit me objektivitetin që ka një mjek kur hap kartelën e një të sëmuri – me fjalë të tjera, duke ballafaquar me kujdes të gjitha simptomat që mund të gjejë, për të mbërritur tek diagnoza. Më duhet të pranoj se, sigurisht nuk qe besimi në Islamin që u

priu në fillim hapave të mi, por, thjesht kërkimi për të vërtetën. Ja, kështu e shikoj atë sot. Qe kryesisht fakti që, pasi e pata mbaruar studimin, pashë në Kur'an tekstin që i ishte zbuluar Profetit.

Ne do të shqyrtojmë thëniet e Kur'anit, që sot, thjesht paraqitin të vërtetën shkencore, tek të cilat njerëzit e kohëve të mëparshme ishin në gjendje të rroknin vetëm kuptimin e tyre të jashtëm. Si mund të imagjinohet që të ketë pasur përndryshime (modifikime) të mëpasme në ajete e këto pjesë të paqarta, të shpërndara nëpër gjithë tekstin e Kur'anit t'i kenë shpëtuar manipulimit njerëzor?! Ndryshimi më i vo-gël i teksteve do të kishte shkatërruar automatikisht lidhjen e shkëlqyer logjike, që është karakteristike për to dhe do të na kishte penguar të përcaktonim pajtueshmërinë e tyre me dijen e sotme. Prania e këtyre pohimeve, të shpërndara nëpër gjithë Kur'anin, është për vëzhguesin objektiv një vulë e qartë e vërtetësisë, e autenticitetit.

Kur'ani iu bë i njohur njeriut gjatë Zbulësës (Revelatës), e cila zgjati mbi njëzet vjet. Ajo rrok dy periudha kohe, me pothu-

ajse gjatësi të njëjtë para dhe pas Hixhrit.¹ Nga kjo pikëpamje, ishte e natyrshme që idetë me kah shkencor të ishin të përhapura nëpër tërë Librin. Në rastin e studimit si ky që kemi bërë ne, na është dashur t'i rigrupojmë ato sipas temës, duke i tubuar ato sure pas sureje.²

Si mund të klasifikoheshin ato? Unë nuk munda të gjeja ndonjë të dhënë në Kur'an që të më sugjeronte ndonjë klasifikim të veçantë; kështu që kam vendosur t'i paraqit ato sipas klasifikimit tim vetjak.

Mua më është dukur që tema e parë për t'u trajtuar, është Krijimi. Këtu është e mundshme të krahasohen ajetet (vargjet) që kanë të bëjnë me këtë temë me idetë e përgjithshme që mbisundojnë sot për formimin e Gjithësisë. Më tej, kam veçuar

¹ *Hixhri* – (nga arabishtja *hixhra* – emigrim) emigrimi i Profetit Muhamed (pagja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në vitin 622 nga Meka në Medine, për t'i shpëtuar përndjekjes së parisë idhujtare; data, nga e cila fillon numërimi i viteve sipas kalendarit islam. (*shënim i përkthyesit*)

² *Sure* (arabisht *sura* ose *surah*) krye, kreu (i një libri). Kur'ani ka 114 sure. (*shënim i përkthyesit*)

vargje sipas titujve të përgjithshëm të mëposhtëm: *Astronomia, Toka, Bota shtazore dhe bimore, Njeriu dhe në veçanti, Riprodhimi njerëzor*; kjo e fundit është një temë, së cilës i lihet vend shumë i rëndësishëm në Kur'an. Këtyre titujve të përgjithshëm mund t'u shtohen nëntituj.

Veç kësaj, unë e mendova të dobishme të krahasoja tregimet kur'anore me ato biblike nga pikëpamja e dijes së sotme. Kjo është bërë për tema të tilla, si *Krijimi, Përmbytja dhe Eksodi*.

KRIJIMI I GJITHËSISË

Le të shqyrtojmë, së pari Krijimin, siç përshkruhet në Kur'an.

Këtu del një ide e përgjithshme, jashtë-zakonisht e rëndësishme: pangjashmëria me tregimin biblik. Kjo ide hedh poshtë para-lelet, që hiqen shpesh dhe gabim nga autorët perëndimorë, për të nënvizuar me çdo kusht ngjashmëritë ndërmjet dy teksteve.

Kur flitet për Krijimin, ashtu si edhe për tema të tjera, ka një prirje të fuqishme në Perëndim që mëton se Muhamedi veçse na paska kopjuar idetë e përgjithshme të Biblës! Le të krahasojmë “gjashtë ditët e Krijimit”, “plus edhe një ditë pushimi – e Diela e Zotit”, siç përshkruhen në Bibël me ajetin nga surja *El A'raf* (7:54):

Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi Qiejt dhe Tokën në gjashtë ditë.

Duhet të theksojmë në çast, mu këtu se komentuesit e sotëm të Kur'anit, kur interpretojnë fjalën *ejjam*, një përkthim i së cilës është “ditë”, kanë parasysh “periudha të gjata kohore” ose “epoka” dhe jo periudha kohore njëzetekatërorëshe.¹

Ajo që mua më duket me rëndësi themelore, është që në dallim nga tregimet e Biblës, Kur'ani nuk përcakton radhë në Krijimin e Tokës dhe të Qiejve. Ai përmend edhe Qiejt përpara Tokës, edhe Tokën përpara Qiejve, kur flet për Krijimin në përgjithësi, si në ajetin e sures *Ta Ha* (20:4):

... Një zbulesë prej Atij (Allahut), i Cili krijoi Tokën dhe Qiejt.

Në të vërtetë, nocioni që duhet të nxirret

¹ Në suren 22, ajeti 47 thuhet se Dita e Allahut është 1000 vjet (me vitin tonë 365 / 366 ditë), kurse në Suren 70, ajeti 4, Dita krahasohet me 50 000 vjet. Kjo do të thotë se mund të numërojmë 6 epoka të mëdha të evolucionit të Tokës sonë materialiste, fizike. (*shënim i përkthyesit*)

nga Kur'ani është ai i bashkëshoqërimit (bashkekzistencës) në evolucionet qiellore dhe tokësore. Ka, gjithashtu, të dhëna absolutisht themeltare për qenien e një mase gazore fillimtare (*dukhan*), e cila është e vetme (unike) dhe elementet e së cilës, megjithëse në fillim ishin të shkrira së bashku (*ratk*), më pas, u veçuan (*fetk*). Ky nocion shprehet në suren *Fussilet* (41:11):

Dhe Zoti iu kthye Qiellit, kur ai ishte tymnajë.¹

I njëjti nocion shprehet në suren *El Enbija* (21:30):

A nuk e shikojnë jobesimtarët që Qiejt dhe Toka ishin ngjitur (si një unitet i Krijimit) para se Ne t'i ndanim?

Procesi i veçimit solli si rrjedhojë formimin e botëve të shumta – një nocion që del shumë herë në Kur'an e që njëherazi ka formuar vargun e parë në suren *El Fatiha* (1:1):

¹ Tym, re tymi, mjegull ose avull.

“Lavdërimi është për Allahun, Zotin e Botëve”.

E gjitha kjo është në pajtim të përsosur me idetë e sotme për ekzistencën e një mjegullnaje (nebuloze) parësore dhe për procesin e ndarjes dytësore të elementeve që kishin formuar masën e vetme (unike) fillimtare. Ndarja solli formimin e galaktikave dhe pastaj, kur këto u ndanë, formimin e yjeve, nga të cilët lindën planetet.

Në Kur'an, në suren *El Furkan* (25 :59) përmendet, gjithashtu, një Krijim i ndërmjetëm midis Qiejve dhe Tokës:

Zoti është Ai që Krijoi Qiejt dhe Tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre.

Na duket që ky Krijim i ndërmjetëm i korrespondon zbulimit të sotëm të urave të lëndës, të cilat janë të pranishme jashtë sistemeve të organizuara astronomike.

Kjo analizë na tregon, sigurisht se si të dhënat e sotme shkencore dhe pohimet e Kur'anit pajtohen në një numër të madh pikash. Jemi larguar shumë nga teksti biblik,

me ato etapat e tij të njëpasnjëshme, që janë tërësisht të papranueshme, sidomos nga ai që e vë Krijimin e Tokës (ditën e tretë) përpara Krijimit të Qiejve (ditën e katërt), kur është një fakt i njohur që planeti ynë vjen nga ylli i vet – Dielli. Në të tilla rrethana, si mund të fantazojmë që një njeri, i cili na e paska marrë frymëzimin e tij nga Bibla, mund të kishte qenë autori i Kur'anit dhe vetë, me dëshirën e vet ta ketë korrigjuar tekstin biblik, për të arritur te një koncept i përgjithshëm për formimin e Gjithësisë, kur ky koncept nuk do të formohej deri shekuj pas vdekjes së tij?!

ASTRONOMI - DRITA DHE LËVIZJA

Le t'i kthehemi tani temës së astronomisë.

Sa herë që u përshkruaj perëndimorëve hollësitë që përmban Kur'ani për çështje të caktuara të astronomisë, është e pazakontë që dikush të mos përgjigjet se nuk paska asgjë të veçantë në këtë, ndërkohë që arabët kanë bërë zbulime të rëndësishme në këtë fushë shumë më herët se europianët.

Kjo është, në të vërtetë një ide çuditërisht e gabuar, që vjen nga mosnjohja e historisë. Në radhë të parë, shkenca u zhvillua në vendet arabe shumë kohë pasi pati mbërritur Zbulesa kur'anore. Së dyti, dija shkencore e kulmit të qytetërimit islam nuk do ta kishte bërë të mundur që një njeri të kishte shkruar pohime për Qiejt, të krahasueshme me ato të Kur'anit.

Këtu, përsëri, tema është aq e gjerë, sa unë mund të bëj vetëm një skicim të saj.

Ndërsa Bibla flet për Diellin dhe për Hënën si dy trupa ndriçues qiellorë, të ndryshëm në madhësi, Kur'ani i dallon ata duke përdorur cilësime të ndryshme: dritë (*nur*) për Hënën, pishtar (*siráxh*) për Diellin. I pari është trup inert që pasqyron dritë; i dyti është formim qiellor në gjendje djegieje të përhershme dhe një burim i dritës dhe i nxehtësisë. Fjala “yll” (*nexhm*) shoqërohet nga një fjalë tjetër cilësuese, e cila tregon se ai digjet dhe konsumon vetveten, duke u futur nëpër errësirat e natës. Kjo është fjala *thakib*. Në Kur'an, fjala *keukeb* duket se ka, sigurisht kuptimin “planetet që janë formime qiellore, që e pasqyrojnë dritën e nuk prodhojnë dritë, siç e prodhon Dielli”.

Sot dihet se si organizimi qiellor mbahet në drejtpeshim nga pozicioni i yjeve në një orbitë të përcaktuar dhe nga ndërveprimi i forcës së rëndesës lidhurazi me masën dhe me shpejtësinë e lëvizjes, secili në lëvizjen e vet. E, a nuk është kjo ajo që përshkruan Kur'ani me terma që

janë bërë të kuptueshëm vetëm në ditët tona, kur ai përmend vendosjen e këtij drejtpeshimi në suren *El Enbija* (21:33)? Aty thuhet:

Është Ai (Allahu), i Cili krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën. Dhe të gjithë (trupat qiellorë) udhëtojnë, secili në orbitën e vet.

Fjala arabe që shënon këtë lëvizje është folja *sebeha* (në tekst *uesbehun*); ajo sjell nocionin e lëvizjes që vjen nga çdo trup lëvizës, p.sh., lëvizje e këmbëve të dikujt që vrapon në tokë ose lëvizje kur ai noton në ujë. Në rastin e trupit qiellor, jemi të detyruar të mos e përkthejmë ndryshe, veçse në kuptimin e saj zanafillës (original), domethënë “*udhëton në orbitën e vet*”.

Përshkrimi i vijimësisë së ditës dhe të natës do të ishte në vetvete mjaft i rëndomtë, po të mos ishte fakti që në Kur'an ajo (vijimësia) shprehet me një gjuhë që sot është kuptimplote: Kur'ani përdor foljen *keuere* në Suren *El Zumer* (39:5) për të përshkruar rrugën kur nata “përdredhon” ose “gjarpëron” rreth ditës dhe dita rreth

natës, mu si te kuptimi zanafillës, konkret i foljes (*keuere*) “mbështjell çallmën përreth kokës”. Ky është një krahasim tërësisht i vlefshëm. E, megjithatë, në kohën kur zbulohej Kur’ani, të dhënat astronomike për ta bërë këtë krahasim ishin të panjohura.

Evolucioni i Qiejve dhe nocioni i një vendi të qëndrueshëm për Diellin përshkruhen, gjithashtu. Ata janë në pajtim me ide të sotme shumë të hollësishme. Duket se Kur’ani ka aluduar edhe për zgjerimin e Gjithësisë.

Pushtimi i hapësirës kozmike. Po. Është ndërmarrë në saje të përparimit të shkëlqyer teknologjik. Përfundimi? Udhëtimi i njeriut në Hënë. Por, patjetër, ky udhëtim të vjen në mendje, kur lexon suren *Err Rrahman* (55:33):

O xhinde dhe njerëz! Në qoftë se mund të depërtoni tej viseve të Qiejve dhe të Tokës, atëherë depërtoni! (Por) ju nuk do të depërtoni, përveçse me Fuqinë (Tonë).

Kjo fuqi vjen nga i Gjithëfuqishmi dhe tematika e tërë Sures është një ftesë për të njohur të Mirat e Allahut për njeriun.

TOKA

Le t'i kthehemi Tokës.

Le të shqyrtojmë, për shembull, këtë ajet të sures *Ez Zumer* (39:21):

A nuk e shikon ti që Allahu lëshon ujë nga qielli dhe e çon atë në Tokë nëpërmjet burimesh? Ai bën që të mbijnë bimë të llojeve dhe të ngjyrave të ndryshme.

Të tilla nocione duken krejt të natyrshme për ne sot, por ne nuk duhet të harrojmë se shumë kohë më parë ato nuk njiheshin. U desh të vinte shekulli XVI, me Bernard Pelisin (Bernard Palissy) që ne të kishim përshkrimin e parë logjik të qarkullimit të ujit. Përpara këtij, njerëzit flisnin për teori, sipas së cilave ujërat e oqeanëve, nën veprimin e erërave, shtyheshin në brendësi të kontinenteve; pastaj ata ktheheshin në oqeanë nëpërmjet një humnere, e cila, që nga koha e Platonit

është quajtur *Tartarusi*. Në shekullin XVII, edhe një mendimtar i madh si Dekarti e besonte atë; madje, edhe në shekullin XIX ende flitej për teorinë e Aristotelit, sipas së cilës uji kondensohej në shpella të ftohta malesh dhe formonte liqene nëntokësore që ushqenin burimet. Sot, ne dimë se shkak për këtë është depërtimi i reshjeve. Në qoftë se krahasojmë faktet e hidrologjisë moderne me të dhënat që gjenden në shumë ajete të Kur'anit për këtë çështje, nuk mund të mos vëmë re shkallën e lartë të pajtimit midis tyre.

Në gjeologji, një fakt, i mësuar kohët e fundit, është dukuria e rrudhjes, si pasojë e së cilës u formuan malet. Po kjo ka ndodhur edhe në koren e Tokës, e cila është si një guaskë e fortë dhe mbi të cilën ne mund të jetojmë, kurse shtresat e saj më të thella janë të nxehta dhe të lëngëta dhe kështu, jomikpritëse për asnjë formë jete. Dihet, gjithashtu se qëndrueshmëria e maleve lidhet me dukurinë e rrudhjes, sepse ishin pikërisht rrudhat që do të jepnin themelet për relievat që përbëjnë malet.

Le të krahasojmë tani idetë e sotme me një varg ndër shumë vargje të Kur'anit, që trajton këtë temë. Ai është marrë nga surja *En Nebe* (78:6, 7):

A nuk i kemi bërë Ne Tokën shtrojë dhe malet shtylla?

Shtyllat (*eutád*), që ngulen në tokë si ato që përdoren për të mbajtur një tendë, janë themelet e thella të rrudhave gjeologjike. Këtu, ashtu si për tema të tjera, vëzhguesi objektiv nuk mund të mos vërejë se nuk ka asnjë kontradiktë me shkencën e sotme. Por më shumë se çdo gjë tjetër, më bënë përshtypje, më së pari thëniet e Kur'anit për gjallesat dhe bimët, sidomos në punë të riprodhimit. Më duhet të theksoj edhe një herë faktin se është pikërisht vetëm në kohët e sotme, që përparimi shkencor e ka bërë më të kuptueshme për ne përmbajtjen e shumë vargjeve (ajeteve) të tilla. Ka, gjithashtu, vargje të tjera, që janë më të lehta për t'i kuptuar, por që fshehin një kuptim biologjik, i cili është shumë i rëndësishëm. Kjo mund të shihet në suren *El Enbija* (21:30), një pjesë e së cilës tashmë është cituar:

**Dhe Ne e bëmë çdo gjallesë nga uji.
Atëherë, a nuk do të besojnë ata?**

Ky është vërtetësim i idesë së sotme që origjina e jetës është uji.

Botanika në kohën e Muhamedit nuk pati përparimin e duhur në asnjë vend, që të vendosej si nocion që bimët kanë edhe pjesët mashkullore, edhe pjesët femërore. Megjithatë, mund të lexojmë ajetin e mëposhtëm nga surja *Ta Ha* (20:53):

(Allahu është Ai, i Cili) lëshoi ujë nga qielli dhe në këtë mënyrë, bëmë të lindin çifte të ndryshme bimësh, secili më vete (i veçuar nga të tjerët).

Sot, dihet që fryti vjen nga bimë që kanë karakteristika seksuale (madje, edhe kur vjen nga lule të papllenuara, si në rastin e bananes). Në suren *Err Rra'd* (13:3) lexojmë:

Dhe të gjitha frytet Ai i bëri në çifte, dy dhe dy.¹

¹ Siç dihet, ashtu si kafshët, edhe bimët kanë aparatit e tyre të riprodhimit – thekët (organi mashkullor) dhe pistilin (organi femëror). Në pjesën më të madhe, e njëjta lule ka edhe thekët, edhe pistilin. Por, në disa raste, këto

Mendimi për riprodhimin në botën e kafshëve është parë lidhurazi me riprodhimin njerëzor. Do ta shqyrtojmë më poshtë.

Në fushën e fiziologjisë, ka një ajet, i cili sipas meje, duket jashtëzakonisht i rëndësishëm. Një mijë vjet përpara zbulimit të qarkullimit të gjakut dhe afër trembëdhjetë shekuj përpara se të dihej çfarë ndodhte në zorrë, që të ushqeheshin organet me anë të procesit të përthitjes tretëse, një ajet i Kur'anit përshkruan buri-min e përbërësve të qumështit në pajtim me këto nocione.

Që ta kuptojmë këtë ajet, na duhet të dimë që në zorrë ndodhin reaksione kimike dhe që prej atje, lëndët që nxirren nga ushqimi kalojnë në rrjedhën e gjakut nëpërmjet një sistemi të ndërlikuar, nganjëherë nëpërmjet mëlçisë, sipas natyrës së tyre kimike. Gjaku i mbart ato tek të gj-

organe janë të specializuara në lule të veçanta dhe edhe në drurë të veçantë, domethënë, ka lule njëseksore ose drurë njëseksorë. Hurma e Arabisë është, për shembull, dru frutor njëseksor. *(shënim i përkthyesit)*

tha organet e trupit, ndër të cilat, janë edhe gjëndrat e qumështit. Pa hyrë në hollësi, le të themi vetëm që në themel, është mbërritja e lëndëve të caktuara nga përmbajtja e zorrëve në enët e vetë murit të zorrëve dhe mbartja e këtyre lëndëve nga rrjedha e gjakut.

Ky koncept duhet të vlerësohet plotësisht, në qoftë se do të kuptojmë këtë ajet të Kur'anit nga surja *En Nahl* (16:66):

Me të vërtetë, te bagëtia ka një mësim për ju. Ne (Allahu) ju japim për të pirë nga ajo që është brenda trupit të tyre, që vjen nga sekrecionet dhe gjaku – qumështin e pastër dhe të shijshëm për ata që e pinë atë.

KRIJIMI I NJERIUT

Tema e riprodhimit njerëzor në Kur'an na çon në një mori pohimesh, të cilat përbëjnë një sfidë për embriologun, që kërkon t'u japë atyre shpjegim njerëzor. Vetëm pas lindjes së shkencave bazë, që do të bashkëndihmonin (kontribuonin) në dijen tonë të biologjisë dhe sidomos, pas shpikjes së mikroskopit, njeriu mundi t'i kuptonte të tilla pohime. Njeriu i fillimit të shekullit të shtatë nuk mund t'i shprehte të tilla ide. Nuk ka asgjë që të tregojë se në atë kohë, njerëzit e Lindjes së Mesme dhe të Arabisë dinin diçka më shumë për këtë temë sesa njerëzit që jetonin në Europë ose gjetiu. Sot, ka shumë myslimanë, me dije të plotë në Kur'an dhe në shkencat e natyrës, të cilët i kanë njohur qartë krahasset që mund të bëhen ndërmjet ajeteve të Kur'anit, që trajtojnë riprodhimin dhe dijes njerëzore. Do të kujtoj gjithnjë komentin e një myslimani tetëmbëdhjetëvjeçar, i rritur në Arabinë Saudite, për çështjen e

riprodhimit, siç shpjegohet në Kur'an. Duke folur për këtë, ai tha: "Ky Libër na jep ne tërë dijen thelbësore për këtë temë. Kur isha në shkollë, e përdornin Kur'anin për të na shpjeguar si linden fëmijët; librat tuaj për edukimin seksual kanë dalë pak vonë në skenë."

Është veçanërisht në këtë pikë, që krahasimi ndërmjet besimeve të përhapura në kohën e Kur'anit, të cilat ishin plot besëtytni e mite dhe përmbajtjes së Kur'anit e të dhënave të sotme na bën të mahnitemi për shkallën e pajtueshmërisë ndërmjet këtyre të fundit dhe për mospërmendjen fare në Kur'an të atyre besimeve të gabuara në atë kohë.

Le të veçojmë tani nga të gjitha këto ajete idetë e sakta të Kur'anit, që kanë të bëjnë me ndërlikueshmërinë e lëngut pllenues dhe me faktin që duhet një sasi pafundësisht e vogël që të sigurohet pllenimi – "kuintesenca", nëse me këtë fjalë mund ta përkthejmë fjalën arabe *sulale*.¹

1. *Kuintesencë* – pjesa më thelbësore, esenca më e pastër, më e zgjedhur dhe më e përpunuar e një substance; shfaqja më e pasur dhe më e përsosur e një cilësie, e një klase gjërash etj. (*shënim i përkthyesit*)

Implantimi (vendosja) i vezës në organin gjinor të femrës përshkruhet përsosurisht në disa ajete me anë të fjalës ‘alak’, e cila është edhe titulli i Sures 96 (*El Alak*):

(Allahu) e krijoi njeriun nga diçka e ngjitshme. (96:2)

Nuk mendoj se ka ndonjë përkthim tjetër të arsyeshëm të fjalës “alak” përveç kuptimit të saj origjinal.¹

Zhvillimi i embrionit brenda mitrës së nënës përshkruhet vetëm shkurtimisht, por përshkrimi është i përpiktë, sepse fjalët e thjeshta që e përcjellin atë u korrespondojnë saktësisht etapave themelore të rritjes së tij (embrionit). Kjo është ajo që lexojmë në një ajet nga surja *El Mu'minun* (23:14).

...Ne i dhamë gjësë së ngjitshme (droçkës së gjakut) trajtën e një cope mishi² të përtypur dhe copës së mishit të përtypur

¹ Domethënë, sipas autorit, “diçka e ngjitshme”. Në “Kur’ani (përkthim me komentim në gjuhën shqipe)” nga H. Sherif Ahmeti: “prej një pike gjaku të ngjizur”. (*shënim i përkthyesit*)

² *Mish* – këtu: copë nga trupi i kafshëve të therura që përdoret për ushqim. (*shënim i përkthyesit*)

i dhamë trajtën e eshtrave. Pastaj, Ne i veshëm eshtrat me mish.¹ Pastaj, Ne e zhvilluam atë në një trajtë tjetër krijimi (me shpirt). I Lartë është Allahu, Krijuesi i Përsosur.²

Termi *mugdah* (mish i përtypur) i korrespondon saktësisht dukjes së embri-onit në një etapë të caktuar të zhvillimit të tij.

Dihet se kockat zhvillohen brenda kësaj mase dhe pastaj vishen me muskuj. Ky është kuptimi i termit *lehm* (mish i paprekur).³

Embrioni kalon nëpër një etapë, ku disa pjesë janë në përpjesëtim, disa në shpërpjesëtim, për t'u bërë më vonë individi. Ndoshta, ky është kuptimi i ajetit 5 në suren *El Haxhxh* (22:5):

¹ *Mish* – këtu: pjesa e tultë e trupit të njeriut a të kafshëve që mbështjell eshtrat. (*shënim i përkthyesit*)

² Një variant tjetër përkthimi i ajeteve mund të ishte ky: “Pastaj, Ne e bëmë spermën droçkëz gjaku të mpiksuar. Pastaj, nga kjo droçkëz Ne bëmë një copëz (fetusi). Pastaj, nga kjo copëz (fetusi) Ne bëmë kockat dhe kockat i veshëm me mish”.

³ Domethënë, jo si më lart “i përtypur”, por si pjesë e tultë e trupit të njeriut ... (*shënim i përkthyesit*)

Ne ju krijuam nga dheu, pastaj nga sperma, pastaj Ne e bëmë atë gjënë e ngjitshme (atë që u krijua nga dheu e më pas nga sperma) një copë mishi, pjesërisht të formuar, pjesërisht të paformuar.

Pastaj, në Kur'an - në suren *Es Sexhde* (32:9) përmendet shfaqja e shqisave dhe e organeve të brendshme:

Ai ju dha ju të dëgjuarit, të parët dhe ndjeshmërinë shpirtërore (zemrën).

Asgjë nuk është në kundërshtim me të dhënat e sotme shkencore dhe për më tepër, asnjë nga idetë e gabuara të kohës nuk depërtoi në Kur'an.¹

¹ *Shënim i përkthyesit:* Për këto tema a çështje që trajton autori, mund të shihni në Kur'an edhe ajete të tjera:

Embrioni: 22:5 / 23:14 / 39:6 / 40:67 / 71:13, 14 / 75:37, 38 / 80:17, 18;

Krijimi i njeriut: 2:30-39 / 40:57 / 56:57-59 / 79:27;

Krijimi i Gjithësisë: 1:1 / 6:101 / 7:54 / 10:3 / 11:7 / 15:85 / 16:3 / 20:4 / 21:30 / 25:59 / 32:4 / 41:11 / 50:38 / 57:4 / 65:12;

Krijimi i Tokës: 6:101 / 7:54 / 10:3 / 11:7 / 13:3 / 15:19, 85 / 16:3 / 21:3 / 25:29 / 32:4 / 41:9-11 / 50:38 / 51:20 / 57:4 / 65:12 / 78:6;

Krijimi i Qiejve: 6:101 / 7:54 / 10:3 / 11:7 / 13:2 / 15:85
Vijon në faqen pasardhëse

KUR'ANI DHE BIBLA

Kemi ardhur tek tema e fundit: ballafaqimi me shkencën e sotme të atyre pjesëve të Kur'anit, të cilat përmenden edhe në Bibël.

Tashmë, i kemi hedhur një vështrim problemit, kur u fol për Krijimin. Më parë kemi theksuar pajtueshmërinë e përkryer ndërmjet shkencës së sotme dhe ajeteve të Kur'anit. Kemi theksuar, gjithashtu

/ 16:3 / 21:30, 32 / 25:29 / 31:10 / 32:4 / 41:11, 12 / 51:47 / 57:4 / 65:12;

Astronomi: 7:54 / 21:33 / 38:87, 88 / 50:6 / 55:33 / 57:25 / 67:3-5;

Drita: 6:1 / 24:35, 40 / 9:32 / 61:8;

Lëvizja në Gjithësi: 27:88 / 13:2 / 35:13 / 39:5 / 36:40;

Malet: 13:3 / 16:5 / 20:105-107 / 21:31 / 31:10 / 41:10 / 59:21 / 73:14 / 78:6-7 / 79:32 / 85:4 / 101:5;

Uji – baza e jetës së çdo gjallese: 21:30 / 24:45 / 25:54;

Uji në natyrë: 7:57 / 15:22 / 23:18, 19 / 25:48, 49 / 30:48 / 35:9 / 39:21 / 50:9-11;

Çifti në çdo gjallesë...: 13:3 / 31:10 / 36:36 / 42:11 / 43:12 / 51:49 / 53:45;

Bimësia: 20:53 / 35:11-13 / 22:18;

Shqisat: 23:78.

se tregimet biblike përmbajnë thënie që shkencërisht janë të papranueshme. Zor se të habit kjo, kur dimë se rrëfenja e madhe e Krijimit që përmban Bibla ka qenë vepër e priftërinjve, që jetuan në shekullin VI para erës së re e që këtej, kemi termin '*priftëror*': tregim '*priftëror*'. Duket se tregimi është konceptuar kryesisht si temë predikimi, për t'i këshilluar njerëzit të respektonin të Dielën. Tregimi është ndërtuar me një fund të përcaktuar shprese dhe, ashtu siç e ka vënë re Ati de Vo (*Father de Vaux*), kreu i mëparshëm i Shkollës Biblike të Jerusalemit, ky fund kishte, në thelb karakter legalist. Bibla ka edhe një tregim tjetër, shumë më të shkurtër e shumë më të vjetër për Krijimin, i ashtuquajtur versioni '*jahovaist*', i cili e vështroi këtë temë nga një kënd krejt i ndryshëm.

Të dy tregimet janë marrë nga Zanafilla (Gjeneza) – libri i parë i Pesëlibërshit (Pentautekut)¹ ose Teurati. Mendohet të ketë qenë Musai (Moisiu) autori i tij, por, siç dihet, teksti që ne kemi sot ka pësuar shumë ndryshime.

¹ *Pesëlibërshi (Pentauteku)* – pesë librat e parë të Dhiatës së vjetër. (*shënim i përkthyesit*)

Tregimi priftëror i Zanafillës është i famshëm për gjenealogjitë e tij fantastike, që shkojnë pas deri tek Ademi (Adami), por të cilat askush nuk i merr shumë seriozisht. Megjithatë, autorë të tillë të Ungjillit, si Mateu dhe Luka, në gjenealogjitë e tyre për Isanë (Jezusin) i kanë riprodhuar ato thuajse fjalë për fjalë. Mateu shkon prapa deri tek Ibrahim (Abrahami), kurse Luka deri tek Ademi. Të gjitha këto shkrime janë shkencërisht të papranueshme, sepse ato vënë një shifër të moshës së botës dhe të kohës kur njeriu u shfaq në Tokë, që nuk përputhet në mënyrë kategorike me atë që është përcaktuar sot me siguri. Kurse Kur'ani nuk ka asnjë të dhënë të këtij lloji.

Më parë u tha, gjithashtu, sa përsosurisht pajtohet Kur'ani me idetë e sotme të përgjithshme të shkencës për formimin e Gjithësisë, kurse tregimi biblik është në kundërshtim me to. Alegoria e ujërave fillestarë zor se ka mbështetje; nuk është i mbështetur as krijimi i dritës ditën e parë përpara krijimit të yjeve, që e prodhojnë këtë dritë; as ekzistenca e një mbrëmjeje dhe e një mëngjesi përpara

krijimit të Tokës; as krijimi i Tokës ditën e tretë përpara Diellit e Dielli, ditën e katërt; as shfaqja e kafshëve të egra ditën e gjashtë, pas shfaqjes së shpendëve të ajrit ditën e pestë: të gjitha këto pohime janë rezultat i besimeve të përhapura në kohën kur ky tekst u shkrua dhe nuk kanë asnjë kuptim tjetër.

Sa për gjenealogjitë që përmban Bibla, të cilat formojnë bazën e kalendarit izraelian dhe pohojnë se sot vjetërsia e botës është 5738 vjet – as këto, zor se janë të pranueshme. Sistemi ynë diellor mund të jetë mbi katër bilionë e gjysmë vjet dhe shfaqja e njeriut në Tokë, me sa dihet sot, mund të vlerësohet me dhjetëra mijëra vjet, *në qoftë se nuk është edhe më shumë*. Prandaj, është patjetër thelbësore të tërheqim vëmendjen që Kur'ani nuk përmban asnjë të dhënë të tillë dhe këto janë vetëm të tekstit biblik.

Ka edhe një temë të dytë, shumë të rëndësishme krahasimi ndërmjet Biblës dhe Kur'anit – Përmbytja e botës. Tregimi i Biblës është, në të vërtetë një përzierje e dy

përshkrimeve, në të cilat ngjarjet tregohen në mënyra të ndryshme. Bibla flet për një përmbytje të gjithësishme (universale) dhe e vendos atë afër 300 vjet përpara Ibrahimit. Nga sa dimë ne për Ibrahimin, kjo do të thotë që përmbytja e gjithësishme të ketë ndodhur rreth shekullit XXI ose XXII para erës së re. Kjo është e pavërtetë, po të kemi parasysh të dhënat historike. Si mund të pranojmë idenë se në shekullin XXI ose XXII para erës së re, i tërë njerëzimi qenka fshirë nga faqja e Dheut dhe nga një kataklizëm i gjithësishëm, kur dimë se kjo periudhë i korrespondon, për shembull asaj që parapriu Mbretërinë e Mesme në Egjipt, që datohet afërsisht në kohën e Periudhës së Parë të Ndërmjetme, përpara dinastisë së njëmbëdhjetë?

Asnjë nga këto pohime nuk është i pranueshëm sipas shkencës së sotme. Nga kjo pikëpamje, ne mund të masim hendekun vigan që ndan Biblën nga Kur'ani. Në kundërshtim me Biblën, tregimi i Kur'anit e trajton Përmbytjen duke e kufizuar te gjindja e Nuhut (Noes). Ata u ndëshkuan për mëkatet e tyre, ashtu siç janë ndëshkuar

edhe popuj të tjerë jobesimtarë. Kur'ani nuk e vendos Përmbytjen në kohë. Nuk ka absolutisht asnjë objekt historik ose arkeologjik në tregimin e Kur'anit.

Pikë e tretë krahasimi, tejet e rëndësishme, është historia e Musait (Moisiut) dhe sidomos, Eksodi i izrealianëve nga Egjipti, të skllavëruar nga Faraoni. Këtu unë mund të jap vetëm një përmbledhje shumë të ngjeshur të studimit të kësaj teme, që është në librin tim¹. Kam shënuar pikat ku tregimet biblike pajtohen ose ku nuk pajtohen me ato kur'anore dhe,

për disa hollësi kam gjetur pika ku të dy tekstet plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë shumë të dobishme. Ndër shumë hipotezat që kanë të bëjnë me pozitën që zë Eksodi në historinë e Faraonëve, unë kam arritur në përfundimin që më e mundshmeja është teoria që e bën Merneptehun vazhduesin e

¹ Libri është "La Bible, la Coran et la Science". Shih në Parathënie. Libri ka 269 faqe. Është përkthyer në gjuhën angleze. Autori ka botuar edhe një libër tjetër, në të cilin trajtohet origjina e njeriut. Ai ka 219 faqe. Është përkthyer në gjuhën angleze, me titullin "Éhat is the Origin of Man". (shënim i përkthyesit)

Ramsesit II, Faraon të Eksodit. Ballafaqimi i të dhënave që përmban Bibla¹ me të dhënat arkeologjike flet fuqishëm në favor të kësaj hipoteze. Jam i lumtur që mund të them se tregimi biblik jep një dëshmi me peshë, që na bën ta vëmë Musanë në historinë e Faraonëve: Musai lindi në kohën e mbretërimit të Ramsesit II. Për këtë arsye, të dhënat biblike kanë vlerë të konsiderueshme historike në punë të historisë së Musait.

Studimi mjekësor i mumies së Merneptehut ka sjellë informacion të vlefshëm të mëtejshëm për shkaqet e mundshme të vdekjes së atij Faraoni. Fakti që sot e kemi mumien e atij Faraoni që, për të qenë të saktë, është zbuluar më 1898, është me rëndësi themelore. Bibla tregon se mumien e përpiu deti, por nuk jep ndonjë hollësi se ç'u bë më pas me të. Kurse Kur'ani, në suren *Junus* (10:92) tregon se trupi i Faraonit, i cili ishte për t'u ndëshkuar, do të nxirrej nga deti:

¹ Në tekst – *Holy Scriptures* (Shkrimet e Shenjta) = Libri / Bibla, si përmbledhje e shkrimeve të krishtere. (*shënim i përkthyesit*)

Këtë ditë, Ne do ta shpëtojmë¹ trupin tënd (të vdekur), që (ti o Faraon) të jesh Argument për ata që vijnë pas teje. Por, vërtet, shumë nga njerëzit janë të pavëmendshëm ndaj Argumenteve Tona.

Ekzaminimi mjekësor i mumies ka treguar, për më tepër se trupi i Faraonit nuk mund të ketë qëndruar në ujë për shumë kohë, sepse ai nuk tregon shenja dëmtimi që vijnë nga qëndrimi gjatë në ujë. Këtu, përsëri, ballafaqimi i thënies së Kur'anit me të dhënat që jep shkenca e sotme nuk sjell as kundërshtimin më të vogël nga pikëpamja shkencore.

Dhiata e vjetër është një përmbledhje krijimesh letrare, të shkruara gjatë afro nëntë shekujsh, e cila ka pësuar shumë ndryshime. Pjesa e interpretuar nga njeriu në kompozimin ekzistues të teksteve të Biblës është mjaft e madhe. Kurse Zbulesa kur'anore ka një histori krejt tjetër. Që nga çasti kur ajo iu kumtua për së pari njeriut, u mësua përmendsh dhe u shkrua sa ishte gjallë Muhamedi. Është pikërisht kjo që

¹ Do ta nxjerrim nga deti. (shënim i përkthyesit)

Kur'ani nuk shtron asnjë problem në punë të vërtetësisë, të autenticitetit. Një shqyrtim krejt objektiv i Kur'anit në dritën e shkencës së sotme na bën të njohim pajtueshmërinë midis tyre - Kur'anit dhe Shkencës, siç është përmendur tashmë në raste të njëpasnjëshme. Kjo na bën ta quajmë krejt të pamendueshme që të ketë qenë autor i pohimeve të tilla një njeri i kohës së Muhamedit, kur kemi parasysh gjendjen e dijes në ditët e tij. Të tilla konsiderata janë pjesë e asaj që i jep Zbulesës kur'anore vendin e saj të pashoq dhe që e detyron shkencëtarin objektiv të pranojë paaftësinë e tij për të dhënë një shpjegim që i drejtohet vetëm arsytimit materialist.

DRITA E ZBULESËS

Hyrje

Çfarë është jeta?

Qenia e njeriut në këtë botë dhe krijimi i tërë kësaj Gjithësie nuk janë ndodhi të thjeshta rastësore, as produkte të një natyre rastësore. Kjo Gjithësi e edhe çdo atom i vetëm i saj tregon e provon qartë se është Krijim i një Krijuesi të Dashur, të Mëshirshëm dhe të Gjithëfuqishëm. Kjo Gjithësi e edhe çdo atom i vetëm i saj na çon te njohja e këtij Krijuesi të Dashur, të Mëshirshëm dhe të Gjithëfuqishëm. Pa një Krijues askush e asgjë nuk mund të ekzistojë. Çdo njeri e di se ai ekziston dhe se ekzistenca e tij varet nga një Krijues. Çdo njeri e di të sigurt se nuk mund ta krijojë

vetveten. Prandaj është detyra e tij ta njohë Krijuesin e tij mjeshtëror – Zotin.

Njerëzimi

Njeriu është krijesë e pashoqe. Zoti e ka vënë njeriun si Përfaqësuesin a Mëkëmbësin e Tij, për të sunduar mbi të gjitha krijesat e tjera të kësaj bote. Ai është pajisur me ARSYEN, e cila e dallon atë nga të gjitha gjallesat e tjera. Profeti thotë: *“Allahu nuk ka krijuar asgjë më të mirë se Arsyeja dhe asgjë më të përsosur e më të bukur se Arsyeja...”*.

Bashkë me aftësinë për të dalluar e shquar, njeriut i është dhënë vullneti i lirë për të zgjedhur për vete një mënyrë jetese të denjë për pozitën e tij si Përfaqësues i Zotit ose të bjerë më poshtë se kafsha a krijesa më e ulët e të gjitha kafshëve a krijesave. Njeriu lind i pastër e i pamëkat. Atij i është dhënë vullneti i lirë të bëjë vepra të mira ose të zhytet në mëkate.

Udhëheqësia e Zotit

Zoti, nga Dashuria dhe Mëshira e madhe që ka për njerëzimin, nuk na ka lënë në errësirë, që ta gjejmë rrugën e drejtë vetëm me sprovë dhe gabime. Bashkë me aftësinë intelektuale për të gjykuar, Zoti na dha UDHËHEQËSINË E VET, e cila përvijon Kriterin për të vërtetën, për dijen dhe për realitetin e qenies sonë në këtë botë dhe në Botën e Ardhshme.

Zbulesat

Që në fillimet e njerëzimit, Zoti ka dërguar Profetë, që të kumtojnë ZBULESËN dhe të ftojnë në rrugën e PAQES SË VËRTETË dhe të BINDJES ndaj NJË ZOTI TË VËRTETË. Ky është ISLAMI. Ky mesazh është përcjellë te njeriu nga brezi në brez nëpërmjet Profetëve – të gjithë duke e ftuar njerëzimin në të njëjtën rrugë. Por, të gjitha

mesazhet a zbulesat e mëparshme të Zotit janë shtrembëruar nga njerëz të brezave të mëparshëm. Për rrjedhojë, Zbulesa e pastër e Zotit zvetënohej nga mitet, nga besëtytnitë, nga adhurimi i idhujve dhe nga ideologji filozofike absurde. Feja e Zotit humbiste në bollëkun e të tilla feve.

Historia njerëzore është një kronikë e lëvizjes së njeriut midis dritës dhe errësirës, por Zoti, me Dashurinë e Tij të Madhe për njeriun, nuk na ka braktisur.

Zbulesa e fundit

Kur njerëzimi ishte në thellësitë e Shekujve të Errët, Zoti çoi të Dërguarin e Tij të fundit, Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që ta shpëtonte njerëzimin. Zbulesa, që i erdhi Profetit Muhamed, përfaqëson burimin e fundit dhe të përhershëm të udhëheqësisë për njerëzimin.

KRITERET E SË VËRTETËS

Si e dimë që një Zbulesë, si Kur'ani është fjala e Zotit? Kriteret e së Vërtetës mund të kuptohen me lehtësi nga të gjithë.

1. Ka mësimet logjike. Përderisa Zoti i dha njeriut arsye dhe intelekt, e kemi për detyrë t'i përdorim këto për të dalluar të vërtetën nga gënjeshtria. Zbulesa e vërtetë, e pashtrembëruar e Zotit është e logjikshme, racionale dhe mund të arsyetohet nga çdo mendje e paanshme.

2. Është e përsosur: Përderisa Zoti është i Përsosur, edhe Zbulesa e Tij është e përsosur dhe e përpiktë, pa gabime, pa harresa e pa kapërcime, pa shtesa a ndërfaqje e pa shumëllojshmëri versionesh. Ajo është pa kundërshti e pa kontradikta në ato që thotë.

3. Nuk ka mite ose besëtytni: Zbulesa që vjen, vërtet nga Zoti, nuk ka mite ose besime të kota, të cilat e ulin dinjitetin e Zotit ose të njeriut.

4. Është shkencore: Përderisa Zoti është Krijuesi i gjithë dijes, Zbulesa e vërtetë është shkencore dhe mund ta përballojë sfidën e shkencës në çdo kohë.

5. Është profetësi: Zoti di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Prandaj, fjala e Tij e profetësive në Zbulesën e Tij do të përmbushet ashtu siç thuhet.

6. Nuk mund të imitohet nga njeriu: Zbulesa e vërtetë, e ardhur nga Zoti është e pagabueshme dhe nuk mund të imitohet nga njeriu. Zbulesa që vjen, vërtet nga Zoti është një Mrekulli e Gjallë, është një Libër i Hapur, që e fton tërë njerëzimin të shohë e të provojë vetë.

I NDERUAR LEXUES

Nuk ka detyrim për njeriun ta pranojë të VËRTETËN. Por, sigurisht njeriu duhet të jetë i interesuar ta njohë të VËRTETËN. Islami na mëson se Zoti i ka dhënë njeriut mendjen, aftësinë për të arsyetuar dhe prandaj Ai pret që njeriu t'i gjykojë vetë gjërat në mënyrë objektive e sistimore, të mendojë thellë, të pyesë dhe përsëri të mendojë thellë.

Askush nuk duhet t'ju shtrëngojë të merrni një vendim të nxituar, të pranoni cilindo nga mësimet e Islamit, sepse Islami na mëson që njeriut duhet t'i jepet liria për të zgjedhur. Madje, edhe kur njeriu përballet me të VËRTETËN, ai nuk detyrohet ta përqafojë atë. Por, përpara se ju të nisni të formoni një mendim për Islamin, pyeteni veten nëse keni dije krejt të plotë për të. Pyeteni veten nëse ajo dije është marrë nga burime të një pale të tretë jomyslimane, së cilës vetë, ndoshta, i janë

dhënë vetëm vështrime të rëndomta librash islamikë dhe i duhet ende të gjykojë vetë për Islamin objektivisht e sistematikisht. A është e drejtë të themi si është shija e një gatese vetëm nga fjalët e të tjerëve, të cilët vetë mund të mos e kenë shijuar ende atë? E, pra, edhe ju duhet ta mësoni vetë Islamin nga burime të besueshme dhe jo vetëm ta shikoni atë sa për shije. Ta bluani atë mirë përpara se të formoni një mendim. Ky do të ishte qëndrim intelektual ndaj Islamit.

Kur ta bëni hapin tuaj, Islami do t'ju sigurojë sërish se do të respektohet e drejta juaj e lirisë për të zgjedhur dhe e drejta juaj e lirisë për ta përdorur aftësinë e dhënë nga Zoti për të menduar e për të gjykuar. Çdo njeri e ka këtë vullnet të vetin individual. Askush nuk mund t'ju rrëmbejë këtë vullnet dhe t'ju detyrojë t'i nënshtroheni vullnetit të Zotit. Ju ju duhet ta zbuloni vetë dhe ta merrni këtë vendim vetë.

Bëjeni rrugën tuaj individuale drejt së VËRTETËS, sepse është e këndshme!

اسم کتاب: قرآن و علوم جدید

المؤلف: موریس بوکای

تیرانا: 2014

انام کتاب: قرآن و علوم جدید

نویسنده: موریس بوکای

مترجم: استاد خیری شهو

ویرایش ادبی: استاد خیری شهو

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: مؤسسه قرآن کریم - تیرانا

تیرانا: 2014